



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË

NR.REGJ. 1207
DATA E REGJISTRIMIT 10.10.2024

NR. 5934/12VENDIMI
DATA 17.10.2024

V E N D I M
“NE EMER TE REPUBLIKES”
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË, E PERBERE NGA:

Sot me datë 17.10.2024, perfundova ne shqyrtim në dhomë këshillimi kerkesen qe i perket:

KERUESI: Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), përfaqësuar nga Presidenti z. Fidel YLLI, dtl. 01.09.1962, i lindur në Tiranë, banues në Tiranë, Rr. "Liman Kaba", Parku Olimpik, Tiranë.

OBJEKTI: Depozitimi dhe regjistrimi i Vendimit dt. 05.10.2024 të Asamblesë së Përgjithshme Vjetore te 30-të të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH).

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Shqipërisë; Ligji Nr. 8789, datë 07.05.2001 "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse", i ndryshuar; Ligjit Nr. 8788, datë 7.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", LIGJI Nr. 79/2017 Për SPORTIN, i ndryshuar si dhe Ligji 80/2021 "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse"

VEREN:

Kerkuesi, ka paraqitur ne gjykate kerkesen per regjistrimin e vendimarrjes se Asamblese se Përgjithshme Vjetore të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, të datës 05.10.2024. Komiteti Olimpik Kombëtar është person juridik, i krijuar në formën e shoqatës me anëtarësi, e regjistruar në Regjistrin e OJF-ve me vendim Nr. 5934, datë 22.6.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka qellim promovojë dhe të mbrojë Lëvizjen Olimpikë në Shqipëri në përputhje me Kartën Olimpikë. KOKSH vepron në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", Kartën Olimpikë. Ligji Nr. 79/2017 Për Sportin si

dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këtë fushë të veprimtarisë së saj.

Në Asamblenë e Përgjithshme Vjetore Nr. 30 të datës 05.10.2024, janë marrë këto vendime:

- Ratifikimi i vendimeve të marra në Asamblenë e Përgjithshme Nr. 29 të datës 02.12.2023.
- Miratimi i raportit auditues për vitin 2023.
- Miratim i rialokimit buxhetor për 2023-2024.
- Miratimin e buxhetit për 2024-2025.
- Pranimin e organizatave sportive të reja pranë KOKSH: Federata Shqiptare e Sporteve Elektronike; Federata Shqiptare e Regbisë; Shoqata Kombëtare e Fencing; Shoqata Kombëtare e Kolombofilëve; Shoqata Kombëtare e Triathlon Albania; Shoqata Kombëtare e Surfing.
- Votimi për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Verifikimit dhe Etrikës (KVE) pas dorëheqjes së Znj. Klementina Çaushaj, duke u zgjedhur si anëtare Znj. Elma Meta.

Gjykata vëren se vendimarrje e regjistrueshme është vetëm ajo në lidhje me shtimin e anëtarësisë si dhe me votimin e anëtarit të Komisionit të Verifikimit dhe Etrikës (KVE), për shkak se miratimi i buxhetit apo rialokimi i fondeve janë vendime që nuk kërkojnë regjistrimin në gjykatë. Të regjistrueshme në gjykatë janë vetëm vendimet apo pjesët e tyre, për të cilat ligji për organizatat jofitimprurëse përcakton të detyrueshme për t'u regjistruar, me qëllim që të japin efektet e tyre në raport me të tretët.

Pasi u administruan fashikujt e regjistrimeve të mëparshme, vërehet se formalisht kërkesa është e rregullt dhe duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar ne Kodit Civil, ligji Nr.8788, date 07.05.2001 "Per organizatat jofitimprurese", ligji Nr.8789, date 07.05.2001 "Per regjistrimin e organizatave jofitimprurese";

VENDOSI

1. Pranimin e kerkeses.
2. Depozitimim ne regjistrat e OJF-ve te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, te vendimmarrjeve te mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme Vjetore të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, nr. 30, të datës 05.10.2024.
3. Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen pales kerkuese.
U shpall ne Tirane, me date 17.10. 2024

